

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Lipjani – Raporti komunal

Tetor 2009

Lipjani në shifra

Popullsia	Gjithsej	73773
	Shqiptarë	86.3%
	Serbë	12.8%
	Të tjerë	2.9%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	422
	Numri i fshatrave	72
Shkollimi	Pa shkollë/ filllore e papërfunduar	12.26%
	Filllore/e mesme e papërfunduar	29.43%
	E mesme	49.72%
	Shkollë e lartë	7.22%
	Universitet	1.37%
	Nr. i nxënësve	15,137
	Nr. i mësimdhënësve	811
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	4
	Nr. i shkollave filllore (me paralele të ndara)	48
	Nr. i çerdheve	1
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		10
Nr. i mjekëve		57
Papunësia	Gjithsej	48.91%
	Meshkuj	41.00%
	Femra	65.33%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	45,002
	Të punësuar në sektorin publik komunal	1,543
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	7,454,966
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	730,000
	Të hyrat tjera (Euro)	6,724,966
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	7,012,126 (93%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	2,048,544 (81%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	4,963,582 (98.9%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	42.98%
	LDK	21.21%
	AKR	14.48%
	LDD	8.08%
	AAK	4.47%
	ORA	3.59%
	PDAK	2.71%
	Tjera	2.39%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Basri Demiri (LDK) 2002-2007: Xhevat Olluri (PDK) 2007-2009: Shukri Buja (PDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Lipjanin

Në vendin ku dikur ndodhej qyteti i lashtë i Ulpianës, tani shtrihet Komuna e Lipjanit. Komuna e Lipjanit është komuna me një shtrirje më të mirë territoriale në Kosovë dhe me një potencial për tu zhvilluar më së hovshmi në vitet në vazhdim. Përsikaj kësaj komune kalojnë dy autostradat më të rëndësishme në Kosovë: ajo Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë-Prizren-Morinë. Për shkak të shtrirjes së përshtatshme gjeografike shumë biznese të mëdha janë vendosur në territorin e kësaj komune. Pjesa më e madhe e hapësirës së Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës shtrihet në Komunën e Lipjanit; aeroporti, të gjitha kompanitë ajrore e deri tek taksitë janë të regjistruara si biznese në këtë komunë. Në Komunën e Lipjanit ndodhen edhe vende historike dhe turistike. Atraksioni më i madh turistik që ndodhet në këtë komunë, por edhe më gjerë, është Shpella e Gadimes. Ndër vendet historike për tu vizituar janë edhe vendi i lashtë i Ulpianës dhe fshati Janjevë. Janjeva njihet si vendbanim i hershëm, në të cilën jetojnë banorë të komunitetit shqiptar dhe kroat dhe dikur njihet si qyteza e cila ka hyrje, por nuk ka dalje. Janjeva dhe Shpella e Gadimes kanë filluar të humbin rëndësinë e tyre për shkak të mungesës së përkujdesjes institucionale. Përveç të gjitha këtyre karakteristikave, Lipjani njihet edhe për një fakt interesant: në këtë komunë janë të vendosura pjesa më e madhe e burgjeve në Kosovë.

Problemet aktuale

Edhe pse një komunë me një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe me potenciale të mëdha për zhvillim ekonomik, qytetarët e Komunës së Lipjanit përballen me të njëjtat problema sikurse pjesa tjetër e Kosovës. Edhe në këtë komunë brenga më e madhe e qytetarëve mbetet papunësia dhe varfëria. 48.91% e qytetarëve në këtë komunë janë të papunë. 9.53% e qytetarëve janë të varur nga ndihmat sociale. Përveç këtyre problemeve, probleme më specifike për komunën e Lipjanit janë:

- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Mungesa e një parku dhe hapësirave gjelbëruese;
- Mungesa e sinjalizimit nëpër rrugë;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;
- Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Qyteti i Lipjanit nuk ka ngrohtore. Ky qytet e ka pasur një ngrohtore e cila është shkatërruar gjatë viteve të '80. Vitin e kaluar pjesët e mbetura të ngrohtores janë shitur për hekur dhe është pastruar i tërë vendi ku ka qenë dikur ngrohtorja. Gjatë fushatës paraelektorale të vitit të kaluar ishte premtuar se do të ndërtohet një ngrohtore e re e qytetit, mirëpo deri më tani nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Në këtë qytet të vogël, i cili është duke përjetuar një rritje të shpejtë falë pozitës së tij të përshtatshme gjeografike, ka ndërtesa të mëdha të banimit kolektiv të cilat kanë nevojë për ngrohje. Ndërtesat që janë ndërtuar para shumë viteve nxehjen e sigurojnë përmes drurëve, kurse ndërtesat e reja kanë të rregulluar ngrohjen me rrymë. Por, të gjithë banorët e ndërtesave të banimit kolektiv ankohen se ngrohja me rrymë është e kushtueshme, kurse ajo me dru nuk është e përshtatshme për ndërtesat e banimit kolektiv. Zgjidhjen ata e shohin tek një ngrohtore qendrore e qytetit e cila do të ishte më e përshtatshme dhe më e lirë.

Mungesa e parkut dhe hapësirave gjelbëruese. Në qytetin Lipjanit tani së fundmi është shtruar rruga kryesore e qytetit, që nga hyrja në Lipjan e deri në qendër të

qytetit. Mirëpo trotuaret mbeten ende në gjendje jo të mirë dhe thuajse janë shkatërruar të gjithë, edhe pse ekzistojnë shtigjet për këmbësorë. Qytetarët ankohen se është e vështirë të ecet nëpër trotuar ngase është i mbuluar me lloç. Përveç trotuareve që janë në gjendje jo të mirë, qytetarët ankohen se në qytet nuk ka mjaft hapësira gjelbëruese. Në oborrin e objektit të komunës, në atë të objektit të policisë, në vendin ku ka qëndruar dikur ngrohtorja e qytetit, etj., ka hapësira të mbjellura me bari, por të cilat nuk mirëmbahen dhe qytetarët nuk kanë qasje në to. Në qytetin e Lipjanit ka hapësira të mjaftueshme ku mund të ndërtohet një park, mirëpo një gjë e tillë nuk është bërë deri më tani. Qytetarët, sidomos ata të moshave më të vjetra, ankohen se nuk kanë ku të shëtisin në qytet, për shkak se rrugët nuk janë të mirëmbajtura, ata nuk mund të qëndrojnë në lokalet e shumta për të rinjtë, dhe zgjidhja më e mirë sipas tyre do të ishte një park në qytet. Sipas personave përgjegjës në komunë, ekziston një projekt për ndërtimin e një parku i cili do të lidhej me lumin Sitnica, mirëpo është një projekt i kushtueshëm dhe nuk dihet se kur do të filloj së implementuari. Në anën tjetër, edhe shtrati i lumit Sitnica ka nevojë për përkujdesje. Shtrati i këtij lumi është mbuluar me shkurre dhe bërrilok dhe pas çdo reshje të shiut ndodh që ky lum të del nga shtrati dhe të vërshoj tokat përreth tij.

Mungesa e sinjalizimit nëpër rrugë. Në tërë qytetin e Lipjanit nuk ka shenja të sinjalizimit horizontal në rrugë. Në udhëkryqin kryesor të qytetit, ku vërehet një përqendrim më i madh i këmbësorëve dhe automjeteve, nuk ka shenja të sinjalizimit horizontal dhe për këtë kanë problem edhe këmbësorët, vozitësit por edhe policia. Policia i a hedh fajin komunës për mungesën e sinjalizimit horizontal, dhe edhe këta të fundit ankohen se në mungesë të tyre e kanë të vështirë që të mbajnë rendin në komunikacionin rrugor në Lipjan. Qytetarët kërkojnë që shënjimi i vijave nëpër rrugë të bëhet sa më shpejtë, ngase është një punë e lehtë që mund të bëhet nga ana e komunës. Vendosja e shenjave në rrugë është e domosdoshme sidomos tek udhëkryqi afër Procredit Bankës, dhe afër shkollave në qytet. Për shkak të punimeve në rrugën Fushë Kosovë-Aeroport, shumë qytetarë kanë marrë rrugën për Aeroport përmes Lipjanit apo përmes fshatit Magurë, çka ka ndikuar në rritjen e komunikacionit në qytet dhe në fshatin Magurë. Mungesa e sinjalizimit me këtë rast vetëm sa e ka rënduar gjendjen në komunikacion.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimin e erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike. Janjeva është vendbanimi më i largët nga qyteti i Lipjanit. Për tërë këto vite nuk ka pasur investime në këtë fshat. Ky fshat është i banuar me banorë të komunitetit shqiptarë, kroat dhe rom. Problemi më i madh në këtë fshat është mungesa e kanalizimit. Ujërat e zeza të shtëpive të këtij fshati derdhen në një përroskë në afërsi dhe kjo bën që fshati të kundërmojë. Edhe Shpella e Gadimes si vendi më i vizituar turistik është jashtë përkujdesjes institucionale. Kjo shpellë menaxhohet nga një person privat i fshatit Gadime, i cili pretendon se shpella ndodhet në pronën e tij private. Nga 39 hektarët që ka hapësira e shpellës, 37 ndodhen në pronë publike të komunës. Mos futja e shpellës nën përkujdesje institucionale nga komuna e Lipjanit arsyetohet se kjo është kompetencë e nivelit qendror. Sipas Ligjit për mbrojtjen e natyrës, nenit 25.1, përfshirja e shpellave nën përkujdesje institucionale bëhet me vendim të

Qeverisë së Kosovës. Në bazë të kësaj, në mars të këtij viti Qeveria e Kosovës me vendimin 04/57 ka futur shpellën e Gadimes nën përkujdesje institucionale. Ky vendim do të duhej të zbatohet nga ana e MAPH, mirëpo nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Gjendja në Shpellën e Gadimes nuk është në gjendje të mirë. Si pasojë e punës së gurthyesve afër shpellës, janë vërejtur qarje në shpellë, thyerje të kristaleve, dhe për shkak të dritës jo adekuate në korridore janë krijuar myshqe.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në mandatin e parë qeverisës për dy vite posti i kryetarit të komunës i ka takuar LDK. Në mandatin e dytë, për pesë vite kryetar komune ka qenë Xhevat Olluri nga PDK. Në zgjedhjet e treta lokale të 17 nëntorit 2007, PDK kishte vendosë që të konkurronte për kryetar me Shukri Bujën, i cili i fitoi 8,879 vota apo 41.41%, kurse në raundin e dytë të votimeve i fitoi 10,152 vota apo 63.5%.

Pasi që Komuna e Lipjanit është komunë bujqësore, kryetari aktual pati premtuar se do të kujdeset për ngjalljen e investimeve në bujqësi, si në lavërtari, pemëtari, perimtari, sera bujqësore, etj. Në Lipjan ekziston shkolla e mesme profesionale e bujqësisë e cila është ndihmuar shumë nga organizata norvegjeze "Norges Vell". Kjo organizatë ka investuar shuma të mëdha parash në ngjalljen e bujqësisë në këtë komunë. Gjatë vitit 2008, nuk është bërë asgjë më shumë në aktivitetet bujqësore, apo konkretisht në lavërtari, pemëtari, perimtari dhe sera. Ndër fermerët e vitit të shpallur nga Ministria e Bujqësisë kanë qenë edhe dy fermerë nga Lipjani, të cilët pasi janë shpërblyer nga Ministria e Bujqësisë, janë pritur dhe dekoruar edhe nga vetë kryetari i komunës së Lipjanit. Për këtë pritje fermerët e vitit janë ndarë të kënaqur, por në suksesin e tyre komuna nuk ka kontribuar aspak. Në vitin 2009 është parapa ndërtimi i një fabrike të mishit, rregullimi i shtratit të lumit "Sitnica" i cili do të shërbej edhe për ujitjen e tokave, si dhe privatizimi apo dhënia në shfrytëzim e tokës bujqësore në pronësi të komunës për fermerët e suksesshëm.

Një nga problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët e kësaj komune është edhe mungesa e ngrohtores qendrore të qytetit. Kryetari aktual pati premtuar se në pjesën e dytë të mandatit të tij do të bëjë projektin e ngrohtores me qëllim që në bazë të këtij projekti të fillohet edhe me realizimin konkret të ndërtimit të ngrohtores. Gjatë hulumtimeve tona nuk kemi mund të hasim në një projekt të hartuar për ngrohtoren e qytetit. Ngrohtorja e vjetër e qytetit është shkatërruar gjatë viteve të '80 dhe vitin e kaluar pjesët e mbetura të saj janë shitur për hekur. Disa nga premtimet e dhëna nga kryetari aktual ishin:

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Aktivizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sidomos aktivizimi i degëve bujqësore si lavërtaria, pemëtaria, perimtaria, perimeve në sera, etj.	Nuk ka të dhëna të sakta se si është vepruar në këtë drejtim.
Do të angazhohet në aktivizimin e industrisë nxjerrëse, pasi që në Lipjan nxirren magneziti dhe ferronikeli.	Miniera e "Ferronikelit", e cila prodhon në Drenas, ndodhet në territorin e komunës së Lipjanit. Komuna nuk ka bërë asgjë më shumë në këtë drejtim.
Do të hap punësim të reja, ku me aktivizimin e	Pasi që Komuna e Lipjanit shtrihet në një

dhjetë objekteve industriale do të punësohen 1063 punëtorë;	trekëndësh rrugor shumë të frekuentuar, edhe interesimi i bizneseve për të funksionuar në këto akse rrugore është i lartë. Për këtë, në mandatin e kaluar është shpallur në tender dhënia e tokës në pjesën afër QMI-së ku pas mbylljes së tenderit janë shpallur dhjetë firmat fituese të pronës publike. Bizneset fituese kishin dhënë premtime të ndryshme për numrin e punonjësve që do të angazhoheshin, ku shuma totale e punonjësve që do të aktivizoheshin në këto biznese do të duhej të ishte 1063. Këtë projekt, edhe kryetari aktual kishte premtuar se do ta vazhdohte edhe në mandatin e tij. Mirëpo, deri më tani, nga dhjetë organizatat fituese vetëm "Lesna" ka filluar të ndërtoj diç konkrete, kurse investimet e bizneseve tjera nuk duken askund.
Do të alokoj mjetet për rrugën për Konjuh;	Ky premtim është realizuar.
Në pjesën e dytë të mandatit do të filloj projektimin e ngrohjes qendrore të qytetit;	Qyteti nuk ka ende ngrrohtore. Nuk dihet nëse këtë vit ka filluar projektimi i ngrrohtores së qytetit.
Do të luftoj korrupsionin dhe në rast të shkeljeve për korrupsion do të kujdeset që të procedoj rastet për në gjykata përmes policisë;	Nuk ka asnjë rast të lajmërimit në polici apo gjykata për shkaqë të korrupsionit në komunën e Lipjanit.

Zgjedhjet lokale në Lipjan

Kuvendi Komunal i Lipjanit ka 31 ulëse. Në mandatin e parë qeverisës, shumica e vendeve në KK i ka takuar LDK-së. Dy vite ma vonë, zgjedhjet e dyta lokale nxorën PDK-në si partinë më të madhe në këtë komunë. PDK fitoi 14 ulëse dhe së bashku me një përfaqësues të AAK qeverisën me komunën për pesë vite. Edhe në mandatin e tretë PDK ka shumicën e ulëseve, edhe pse ka një përfaqësues më pak. Edhe numri i votave për këtë subjekt politik ka rënë në krahasim me zgjedhjet e vitit 2002. Humbjen më të madhe të votave në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 e pësoi LDK, votat e së cilës u përgjysmuan. Në tri legjislaturat e gjertanishme vetëm tri parti politike kanë arritur që të përfaqësohen vazhdimisht. Në legjislaturën e dytë (2002-2007) kanë qenë të përfaqësuar edhe dy serbë nga dy parti të ndryshme politike. Kurse në legjislaturën e tanishme edhe komuniteti ashkali ka siguruar një vend.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Lipjanit.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	8317	13	10283	14	8925	13
LDK	10718	16	9923	13	4404	7
AAK	1109	2	840	1	929	1
LDD	-	-	-	-	1677	3
AKR	-	-	-	-	3007	5
ORA	-	-	-	-	746	1
PDAK	-	-	-	-	563	1

DCC	-	-	523	1	-	-
"Povratak"	-	-	391	1	-	-

Numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 76.4%, në zgjedhjet e dyta dy vite më vonë, përkundër faktit se edhe komuniteti serb ju përgjigj ftesës për dalje në zgjedhje, pjesëmarrja ra në 54.87%. Edhe në zgjedhjet e treta lokale u shënuar rënie dhe kësaj radhe pjesëmarrja ishte 47.9%. Në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009, të drejtë vote kanë 48,079 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Lipjan në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	29070	43786	43309	48079
Pjesëmarrja në votime	22209	24027	20767	-
Përqindja e daljes në votime	76.4%	54.87%	47.9%	-

Buxheti i Komunës

Edhe pse një komunë relativisht e vogël, Lipjani ka një buxhet më të madh se sa shumë komuna me madhësi të njëjtë territoriale dhe numër të popullsisë. Kjo për shkak se burimet e të hyrave vetanake të kësaj komune janë më të mëdha për shkak të përqendrimit të një numri të madh të bizneseve private. Që nga viti 2004 e deri më 2008, buxheti total i komunës së Lipjanit është vërtitur brenda shifrës 5 milion €. Përveç në vitin 2006, në të gjitha vitet tjera buxheti i përgjithshëm i komunës ka shënuar rritje. Rritja më e madhe e buxhetit është bërë më 2009, ku për herë të parë në këtë komunë buxheti ka arritur në mbi 7.4 milion €. Po në 2009, edhe shpenzimet për rroga dhe mëditje kanë shënuar një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet tjera.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	4,425,264	512,394	112,154	80,000	2,325,154	7,454,966
2008	3,868,282	554,288	112,154	80,000	1,239,909	5,854,633
2007	3,718,294	537,335	202,154	80,000	1,127,138	5,664,921
2006	3,731,341	610,147	78,577	100,000	1,070,849	5,590,914
2005	3,696,996	621,827	126,381	64,000	1,180,077	5,689,281
2004	3,701,207	1,135,854	-	-	721,431	5,558,492
2003	2,770,014	1,144,006	-	-	465,113	4,528,532

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit në vitin 2008 ka arrit që të shpenzohet në masën 93%. Kjo shifër është shifra më e lartë që është arritur ndonjëherë në shpenzimin e buxhetit në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe e shpenzimeve janë realizuar në tre mujorin e fundit të 2008, kurse deri në fund të shtatorit 2008 vetëm 62.4% e mjeteve ishin shpenzuar.

Sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake, Komuna e Lipjanit zë vendin e parë në krahasim me komunat tjera. Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2008 ka arritë që të arkëtoj të hyrat vetanake në krahasim me planifikimet për 178.76%. Kjo është shifra më e lartë që një komunë ka arritur që të regjistroj me rastin e arkëtimit të të hyrave vetanake në 2008. Të hyrat për gjashtë mujorin e parë të 2009 janë për 11% më të larta se të hyrat për të njëjtën periudhë 2008.

Investimet kapitale

Buxheti i komunës i destinuar për investime kapitale deri në fund të 2008 asnjëherë nuk e ka kalu shifrën 1.2 milion euro. Krahas rritjes së buxhetit të përgjithshëm të komunës më 2009, edhe kategoria e investimeve kapitale ka shënuar rritje. Buxheti për investime kapitale këtë vit është pak më shumë se 2.3 milion euro. Në vitin 2008 Komuna e Lipjanit ka arritur që buxhetin e destinuar për investime kapitale ta realizoj në masën 81%, kurse deri në fund të shtatorit buxheti për investime kapitale ishte shpenzuar në masën 42.2%. Sipas kësaj, gjysma e mjeteve të shpenzuara për projekte kapitale është shpenzuar në tre mujorin fundit. Në periudhën janar-qershor 2009, buxheti i ndarë për investime kapitale është realizuar në masën 35.1%. Tabela më poshtë pasqyron disa nga projektet kapitale të cilat janë realizuar gjatë 2008 dhe 2009.

Tab.5.: Investimet kapitale në Lipjan gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugëve të qytetit	€158,419
2008	Asfaltimi i rrugës Lipjan-Kraiq (faza e I-rë)	€105,556
2008	Asfaltimi i rrugës Dobrajë e madhe	€120,000
2008	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Babush	€120,000
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Krojmir	€145,686
2008	Asfaltimi i rrugës në fshatin Bregu i Zi	€145,000
2009	Asfaltimi i rrugës në fshatin Bujari	€140,000
2009	Asfaltimi i rrugës në fshatin Bujan	€198,000
2009	Asfaltimi i rrugës në fshatin Baincë	€160,000
2009	Rregullimi i tretuareve dhe asfaltimi i rrugës kryesore	€274,272
2009	Asfaltimi i rrugës dytësore	€187,102
2009	Asfaltimi i rrugës në fshatin Mirenë	€120,000

Kuvendi Komunal i Lipjanit ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Lipjanit do të ketë në dispozicion **9,612,623 €** për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Lipjan 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	8,381,599	8,611,263	8,917,926
Të hyrat vetanake në €	935,159	964,846	992,678
Investimet kapitale në €	2,986,007	3,160,432	3,466,184

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Lipjanit për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth **13.1 €** për investime kapitale.

Administrata komunale

Në vitin 2009, në Komunën e Lipjanit, në tre sektorët publik (arsim, shëndetësi, administratë) janë të punësuar 1,543 qytetarë. Ky numër është zvogëluar në krahasim me një vit më parë. Vetëm në administratën komunale janë të punësuar 183 shërbyes civil. Numri i shërbyesve civil në administratën lokale është rritur në krahasim me një vit më parë. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.10/46, ku sipas së cilit në komunat me popullsi nën 100,000 banorë administratat lokale duhet të kenë 1 shërbyes civil për 620 banorë, del se komuna e Lipjanit me rreth 73,000 banorë duhet të ketë më së shumti 166 shërbyes civil. Sipas kësaj, administrata komunale e Lipjanit është e tejgarkuar me staf.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Lipjan sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	1543 ▲
2008	1513
2007	1545
2006	1581 ▲
2005	1567
2004	1597 ▲
2003	1510 ■

Në nëntë drejtoritë komunale që ka kjo komunë, në gjashtë mujorin e parë të 2009 janë dorëzuar 4,242 kërkesa, të cilat, për të njëjtën periudhë, janë zgjidhur në masën 76.68%.

Komuna e Lipjanit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, brenda vitit Kuvendet Komunale duhet të mbajnë së paku dhjetë mbledhje të rregullta. Kuvendi Komunal i Lipjanit gjatë vitit 2008 ka mbajtur 12 mbledhje, kurse në periudhën janar-qershor 2009 ka mbajtur 6 mbledhje. KK i Lipjanit ka miratuar tri rregullore komunale gjatë 2008. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) në 2008 ka mbajtur 11 mbledhje kurse në pjesën e parë të vitit 2009 ka mbajtur shtatë mbledhje. Komiteti për Komunitete ka mbajtur pesë takime më 2008 dhe dy takime në pjesën e parë të 2009. Përveç këtyre dy komiteteve KK i Lipjanit ka të formuara edhe tri komitete tjera. Por nuk ka të formuar asnjë komitet konsultativ, ashtu siç kërkohet me ligj. Gjatë vitit 2008 Kryetari i Komunës ka mbajtur dy tubime publike gjatë tërë vitit. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumente zyrtare kjo komunë ka pasur një kërkesë gjatë 2008 dhe asnjë kërkesë gjatë pjesës së parë të vitit 2009.

Ueb faqja e komunës së Lipjanit ka mungesa të konsiderueshme informacionesh të cilat do t'i nevojiteshin çdo qytetari rreth aktiviteteve të komunës siç janë, p.sh.: shërbimet komunale gati nuk janë të paraqitura fare, projektet komunale nuk mund të gjenden fare, si dhe në pikëpamje të strukturës organizative ueb faqja ka mangësi të mëdha.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit (www.lipjan-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	3
Organizimi komunal	2.67
Shërbimet komunale	1.80
Info rreth qytetit	3.63
Projektet komunale	1
Lajme & lajmërim	3.67
Harta e faqes	1
Kontakt	2
Gjuhët	2
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	4
Mesatarja totale	2.31
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	23

Gjendja në arsim

Në Komunën e Lipjanit arsimi zhvillohet në dy nivele, në atë fillor dhe të mesëm. Në këtë komunë funksionon një çerdhe për fëmijë, 48 shkolla fillore (20 shkolla amë me 28 paralele të ndara) dhe 4 shkolla të mesme (3 shkolla amë me një paralele të ndarë). Gjatë vitit 2008 me mjete vetanake të komunës është bërë ndërtimi i shkollës në Hallaç të Vogël, është meremetuar shkolla fillore në fshatin Rufc. Kurse në 2009 janë bërë investime në shkolla e fshatit Risinoc dhe në Dobrajë të Vogël. Mirëpo edhe më tutje mbeten probleme në infrastrukturën shkollore të Lipjanit. Në shkollën e mesme profesionale "Adem Gllavica" në Lipjan ka mungesë të lokalit dhe mësimi mbahet në tri ndërrime, kurse ora mësimore zgjat vetëm 30 minuta. Përveç infrastrukturës shkollore, problem mbeten edhe në kualitetin e mësimdhënies. Gjatë vitit të kaluar, pikat më të nxehta debatuese në Kuvendin Komunal të Lipjanit kanë qenë rreth arsimit, më saktësisht, akuzat rreth punësimit të kuadrove të reja në sistemin arsimor lokal.

Së shpejti në këtë komunën do të ndërtohet edhe një qendër universitare. Komuna i ka ndarë 5 hektar tokë një institucioni turk të arsimit të lartë QEA "Gulistan" dhe së shpejti pritet ndërtimi i objektit dhe fillimi i punës së këtij institucioni të arsimit të lartë privat.

² (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Gjendja në shëndetësi

Në Komunën e Lipjanit funksionojnë një QKMF, 5 QMF dhe 6 ambulanta të mjekësisë familjare. Vetëm në QKMF në qytetin e Lipjanit punohet me orar 24 orësh, kurse në QMF punohet pesë ditë në javë për 12 orë në ditë. Tri ambulanta punojnë vetëm dy ditë në javë për tetë orë në ditë. Gjatë vitit 2008, është bërë riparimi i kulmit në Janjevë, ku KFOR-i irlandez ka ndarë 11.000 euro për këtë projekt. Në Suhadoll me mjetet financiare të USAID është ndërtua një QMF. Në vitin 2009 parashihet ndërrimi i dyshemesë të QKMF, si dhe ndërtimi i QMF-së në fshatin Gadime.

Në shëndetësinë primare të Lipjanit janë të punësuar 210 punonjës, prej tyre 122 femra, mirëpo asnjëra nga femrat nuk është në pozitë udhëheqëse. Sipas vetë zyrtarëve të drejtoratit, Lipjani ka mjaft kadro shëndetësore, ka 15 specializant të mjekësisë familjare. Në mungesë të një spitali regjional në Prishtinë, rastet më të rënda të gjithë drejtohen në QKUK.

Shoqëria civile

Në Komunën e Lipjanit shoqëria civile nuk është mjaft aktive. Përkundër një numri të madh të organizatave jo qeveritare të regjistruara, vetëm një numër i vogël i tyre kanë aktivitete të kohëpaskohshme. Organizata më aktive në këtë komunë, e cila merret edhe me monitorimin e punës së organeve komunale si dhe shtyrjen përpara të projekteve më me rëndësi për komunitetin, është organizata YAHR (Youth Association for Human Rights). Organizata tjera më pak aktive si dhe me një fokus tjetër të aktiviteteve janë edhe "Jeta Rinore e Lipjanit" dhe "Flaka" – organizatë me mision fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri.

Mediat lokale

Në komunën e Lipjanit vërehet mungesa e mjeteve për informim publik. Në këtë komunë nuk funksionin asnjë radio apo televizion lokal. Edhe pse është e regjistruar dhe mban të drejtën e frekuencave, Radio Galla ka kohë që nuk funksionon. Përveç televizioneve kombëtare, në territorin e kësaj komune mund të shikohen edhe televizionet lokale të Ferizajt dhe TV Mitrovica. Tani së fundmi është tentuar që të hapet një televizion lokal i cili do të emetoj program përmes sistemit kabllor. Disa nga gazetaret ditore kanë korrespondentët e tyre në këtë komunë. Raportimi i korrespondentëve bëhet në bazë të aktiviteteve komunale, dhe qasja është më shumë informuese se sa kritike.

Rendi dhe ligji në Komunën e Lipjanit

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Lipjanit kanë ndodhur 1508 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, të cilat mund të klasifikohen në gjithsejtë 69 fusha të ndryshme të shkeljes së rendit dhe ligjit. Nëse e krahasojmë Lipjanin me komunat tjera sa i përket numrit të rasteve të shkeljes së rendit dhe ligjit, Komuna e Lipjanit radhitet e 13 në Kosovë. Për shumë raste të ndryshme kjo komunë qëndron më lartë në listë. Për shembull për numrin e aksidenteve të ndodhura gjatë një viti Lipjani zë vendin e nëntë në krahasim me komunat e tjera, për vjedhje zë vendin e dhjetë,

abuzime seksuale me 8 raste radhitet e nënta, për kërcënime radhitet e teta, etj. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Lipjan (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	324
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	105
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	14
Vjedhje e pyjeve	1
Incidente lidhur me pronën	51
Vjedhje	403
Abuzime seksuale	8
Shkaktim të dëmtimeve trupore	90
Kërcënime	73
Mashtrime	17
Vrasje	5
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	1

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimoretë mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimoretë lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Lipjanit

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.12%	0.12%	0.30%	0.20%	0.15%
I	400	400	600	350	200
II	300	300	400	300	150
III	200	200	300	250	100
IV	150	150	200	200	100

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në komunën e Lipjanit funksionojnë rreth 966 biznese private. Llojet e veprimtarisë së tyre janë të ndryshme. Për funksionimin e tyre, bizneset pas regjistrimit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, duhet të marrin lejen e punës në Komunën e Lipjanit. Kuvendi Komunal i Lipjanit ka miratuar Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa. Me këtë rregullore janë caktuar shumatat që duhet të paguhet për

marjen e lejes së punës, për të gjitha llojet e bizneseve. Tabela më poshtë tregon disa nga llojet më të shpeshta të bizneseve dhe shumat që duhet ato të paguajnë në këtë komunë.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	1,050 €
KEK	5,000 €
Kompanitë e sigurimit	420 €
Agjencitë turistike	190 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	5,000 €
Transporti i rregullt ajror - Aeroporti	20,000 €
Industria nxjerrëse (nxjerrja e nikelit)	20,000 €
Hotelet	190 - 250 €
Motelet	190 - 250 €
Supermarketet-Hipermarketet	60 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	60 €
Kafeteritë	110 €
Restorant	190 €
Telekomunikimit	90 €
Gurëthyesit	420 €
Blegtoria	320 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrucktharitë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	90 €
Depot e derivateve	1,050 €
Pompat e benzinës	560 €
Barnatoret	150 €
Ndërmarrjet ndërtimore	210- 250 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	130 - 450 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
13. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
14. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
15. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.